PROCESVERBAL I MBLEDHJES DATE 28.01.2026

Sot ne sallen e mbledhjeve te K. B. Devoll zhvillohet mbledhja e rradhes sipas njoftimit te dates 22.01.2026.

Te pranishem ne salle:
Alfredi Gjata ,Valbona Spaho,Imelda Cucka, Oljana Comka, Festim Kaso, Oliver Mulla Lindita Cokani, Arsina Mazelliu, Ermena Xhaci, Ilir Hoxha, Esmeralda Medolli, Kledi Cenkolli, Eduard Maho, Paola Spaho, Genti Demcolli.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 1, miratimin e rendit te dites.

Hapet votimi: 15pro, 0 kunder, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 2. Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se dates 26.12.2025

Genti Demcolli :Mbledhja e fundvitit e dates 26.12.2025 eshte ashiqare qe eshte shkelur rregullorja e brendshme . Tek njoftimet une nuk e kuptoj juve Kryetar dhe Znj. Sekretare e Keshillit cfare ju pengon , na e thoni qe lajmerimet te behen konfort rregullores . Me sakte neni 60 pika 3 thote "njoftimi behet nga sekretari i keshillit jo me pak se 5 dite " (dite pune nga data e mbledhjes qe do te zhvillohet), njoftimi eshte bere 2 dite pune. Email na ka erdhur ne date 23 nga sekretarja e keshillit. Kete nuk e mohoni dot , date 25 eshte dite pushimi zyrtare , i bie dy dite para .Tani kjo eshte e perseritur viti i trete radhasi , mbledhja me e rendesishme e vitit ku dikutohet buxheti ,tani si ta mar kete une? Neglizhence a cfare?

Alfredi Gjata : Mund te qellojne edhe ditet e shtune e diele .

Genti Demcolli: Po por rregullorja ta parashtron shume qarte, tani cfare ju pengon juve e beni qellimisht, ju pengojn zyrat e bashkise , nuk i perpiloni dot ? Une nuk e kuptoj dot nese i arrijne dy dite keshilltareve per te pare keto PV apo vijne sa per te marre rrogen.

Eduard Duro: Administrata e Bashkise nuk eshte problem Sepse kane qene ne pune deri ne date 31 .

Alfredi Gjata: Nje pjese e keshilltareve kerkonin , per arsye te festave te fundvitit ta benin sa me perpara . Materialet jane sjelle ne date 20 por per disa arsye jane dashur te rishikohen , per kete arsye ju eshte derguar ne daten 23, mbyllet diskutimi.

Hapet votimi :14 pro 1 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 3 Projekt-Vendim Nr.1 Date 22.01.2026 , "Për një ndryshim

në vendimin nr.98, datë 26.12.2025 të Këshillit Bashkiak Devoll "Per rishikimin dhe miratimin e struktures, organikes dhe nivelit të pagave te Agjencisë së Sherbimeve në varësi te Bashkise Devoll, per vitin 2026".

Eduard Duro: Ishte periudha qe doli VKM nga 47000 u be 50000 dhe duhej futur perseri per miratim KB

Hapet votimi: 14 pro 0 kunder 1 abstenim

Alfredi Gjata :Vazhdojme me piken 14 Projekt-Vendim Nr.12 Date 22.01.2026 "Per rishayrtimin e disa pikave ne Vendimin nr. 97, date 26.12.2025 te Keshillit Bashkiak Devoll "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionareve te zgjedhur ose te emeruar, te nepunesve civile dhe te punonjesve administrative te Bashkise Devoll per vitin 2026 ".

Do ta kalojme kete PV tani meqenese jane pak a shume te njejte.

Adriana Rrushitaj: Mbas verifikimit te institucionit te prefektit ata kane kerkuar disa qartesi teknike , per disa elemente si diploma, paga etj , te cilat ishin te shprehura me fjale por u kerkuan ne tabele . Nese do te beni ndryshimin mes PV dhe relacionit te pare me kete sot , thjesht ka ndryshuar forma e te shprehurit . Jane kerkuar edhe disa interpretime te tjera funksionale te disa pozicioneve sic eshte edhe drejtoria e Arsimit dhe pozicionet e cerdhes, si pergjegjes cerdhe dhe specialist cerdhe per te cilet kerkonin qe te trajtoheshin sipas ligjit te arsimit parauniversitar.

Ne vazhdojme te mbajme te njejtin qendrim si u shpjegua dhe heren e pare, vetem se sqarimi eshte me i detajuar per arsye se keto jan funksione administrative te Bashkise dhe jo funksione te arsimit me pergjegjesi menaxhuese kordinuese, planifikuese , pra nuk kan te bejne me kurrikula mesimore apo programe mesimore por jane funksione administrative te Bashkise.

Hapet votimi: 15 Pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 4 Projekt-Vendim Nr.2 Date 22.01.2026 , " Per percaktimin e destinacionit te perdorimit te fondit të grantit të bazuar në performance dhe shtesë në buxhetin e vitit 2025".

Alfredi Gjata: Fondet kalojne për intvestime në sektorin e Kultures.

Nuk ka diskutime .

Hapet votimi: 15 Pro 0 kunder 0 Abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 5 Projekt-Vendim Nr.3 Date 22.01.2026 , "Per miratimin e

kritereve per dhenien e ndihmes ekonomike per familjet aplikuese, te cilat nuk jane shpallur perfituese nga sistemi i pikezimit dhe qé do te trajtohen me ndihmé ekonomike nga fondi i kushtezuar per bllok-ndihmen ekonomike deri ne 6% per periudhën Janar-Dhjetor 2026".

Nuk ka diskutime

Hapet votimi: 15 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 6 Projekt-Vendim Nr.4 Datë 22.01.2026 "Për miratimin e kritereve per dhënien e ndihmës ekonomike per familjet aplikuese , te cilat nuk janë shpallur perfituese nga sistemimi I pikëzimit dhe që do te trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor per periudhën Janar- Dhjetor 2026".

Zerina Sinani: Keto jane kritere ne menyre qe ne momentin e perzgjedhjes te meren parasysh keto kritere.

Hapet votimi :14 pro 0 kunder 1 abstenim

Alfredi Gjata: vazhdojme me piken 7 Projekt-Vendim Nr.5 Datë 22.01.2026 "Për miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi kushtëzuar deri në 6 % për bllok- ndihmën ekonomike për muajin Dhjetor 2025".

Ilir Hoxha: Tek ky PV eshte nje pike , pika 13 e cila eshte abuzive per mendimin tim me te cilin mund te abuzosh kur te duash , me mir te hiqet fare.

Eduard Duro: kjo eshte per ata qe kane mbushur moshen e pensionit dhe nuk perfitojne pension sepse nuk kane vite sigurimesh

Ilir Hoxha: ne rregull por nga qe mungonte fjala pension dhe te konfuzon.

Hapet votimi: 15 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: vazhdojme me piken 8 Projekt-Vendim Nr.6 Datë 22.01.2026 "Per percaktimin e vlerës mesatare te tregut per subvencionimin e qirase që perfitojne familjet e pastreha qe banojne me qira né tregun e lire dhe nuk kane te ardhura te mjaftueshme per te perballuar vete gjithë vleren e qirase per vitin 2026".

Nuk ka diskutime

Hapet votimi: 15 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata :vazhdojme me piken 9 Projekt-Vendim Nr.7 Date 22.01.2026 "Per miratimin e sistemit të pikezimit per programin "subvencionim qiraje per vitin 2026".

Marilda Bejleri : Si cdo vit programet e strehimit duhet patjeter te miratohen ne keshillit Bashkiak . Disa PV kane te bejne me rregulloren , me vleren e tregut te subvencjonimit te qerase, me perberjen e komisionit te strehimit dhe sistemin e pikezimit te cilet do te dalin perfitues nga ky program .

Hapet votimi :15 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata : Vazhdojme me piken 10 Projekt-Vendim Nr.8 Datë 22.01.2026 "Për miratimin e listes qe do te trajtohen me subvencionim qiraje per vitin 2026".

Festim Kaso: keto lista miratohen 1 her ne vit apo cdo muaj?

Zerina Sinani: kjo eshte lista aktuale qe ne kemi , nese ne kemi raste te reja mblidhet komisoni i strehimit qe ju do te miratoni dhe komisonin mbas ketoj PV , ne trajtojme edhe dosjet e reja qe dalin gjate vitit .

Festim Kaso: me fal , nqs nje person ka ikur dhe nuk banon me ai vazhdo te mare subvencionimin?

Zerina Sinani: jo paqellim te gjithe kete liste ja kam lene per detyre specialistes te sektorit tim , e cila po ben verifikim tek cdo familje pikerisht per ktet gje.

Ne bejme vizita te pakten cdo 3 muaj neper familje.

Hapet votimi :15 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 11. Projekt-Vendim Nr.9 Date 22.01.2026 "Për ngritjen e komisionit të strehimit për vitin 2026".

Zerina Sinani: si edhe ju shpjegova per te gjitha dosjet qe ne trajtojme , qofte edhe per kredite e buta qe kishim vjet, qofte edhe per bonusin e qerase ky komison strehiminsherben sepse ne kete komision shqyrtohen te gjitha dokumentat e nevojshme. Ne kte komision ka pothuajse perfaqesuese nga drejtorit keyesore , nga buxheti nga zyra juridike , perfaqesues ka komuniteti rom/ egjiptian , ku ne nje pjese te mire te atyre i trajtojme me keto programe , nga emergjencat civile.

Hapet votimi:15 pro 0 kunder 0 abstenim

***Alfredi Gjata*:** Vazhdojme piken 12 Projekt-Vendim Nr.10 Datë 22.01.2026 "Për miratimin e rregullores dhe funksionimin e komisionit te strehimit në Bashkine Devoll per vitin 2026".

Zerina Sinani: Nuk ka asnje ndryshim ne rregullore .Komisioni ka shqyrtuar cdo dosje qe ka ardhur dhe ka kaluar.

Hapet votimi 15 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: vazhdojme me piken 13 Projekt-Vendim Nr.11 Date 22.01.2026 "Per miratimin e rregullores sé qendres shumefunksionale e komunitare Devoll dhe regullores sé gendres ditore per te moshuarit e cila eshte ne varêsi te qendres shumefunksionale komunitare Bashkia Devol 2026-2027 "

Nuk diskutime

Hapet votimi: 15 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Na ka ardhur nje PV icili ka nr 13. Jashte rendit te dites ,Për miratimin e një ndryshimi në listen e inventarit të pronave të paluajtshme të Bashkisë Devoll , miratuar me VKM-Nr.764 datë 07.11.2012" Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme

publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Bilisht, të Qarkut të Korçës."

Erjon Rado:ne kete PV behet fjale per pasurine mbir pasurine mbi fshatin Bitincke. Ka shprehur interes nje provat per nje kohe te mevonshme per te mare me qera per interesa te Bashkise sipas ligjeve . Eshte kategori malore dhe bujqesore , aktualisht keto jane ne pronesi te Bahkise por jo me dokumenta fikse , toka ne fjale eshte ajo per te cilen ne zhvilluam konsultime publike .

Eduard Maho: Keto realishf jan toka te pafrytshme .

Erjona Rado: Prandaj na duhet ta privatizojme si Bashki qe te nderohet nje kategori e cila eshte gabim aty.

Alfredi Gjata: Une mendoj qe keto toka ti bejme ne pronesi te Bashkise dhe gjithashtu investimet per panele .

Eduard Duro: Kam disa propozime per bashkefinancim qe te jete dhe Bashkia investitore e paneleve fotovoltaike .Une i kam mar propozimet ne protokoll, tani do te bej nje bisede me ministren e ekonomise dhe sipermarjes per te shqyrtuar procedurat ligjore te krijimit te SHA apo SHPK te ndryshme . Dhe gjithashtu per te pare perqindjen qe ne mund te hyjme ne bashkepunim une do te flas me zyren juridike, per te pare anen ligjore dhe muajin tjeter do tju sjell propozimin per te mare autorizimin tuaj per te hyre ne marveshje me privatet . Jo ti leshojme vetem me qera por ne te jemi edhe bashkepronare te ketyre parqeve fotovoltaike .

Nuk ka me diskutime:

Hapet votimi:15 pro 0 kunder 0 abstenim

Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Protokollues:
Kostandina Brahollë